

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Tonka Berishaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve G.J. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i detyrës apo i autoritetit zyrtar , nga neni 422 par.1 të KPRK-së dhe S.M. , T.M. dhe Sh.M. që të tre nga fshati D., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të : mbrojtësve të akuzuarve T.M., Sh.M. , dhe ankesës të të akuzuarit S.M., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, PKR.nr.55/2018 datë 14.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.07.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe ajo e të akuzuarit S.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, PKR.nr.55/2018 datë 14.03.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë me aktgjykimin PKR.nr.55/2018 datë 14.03.2018, konform nenit 364 par.1 nënpar. 1.3 të KPP-së, e ka liruar nga akuza të akuzuarin G.J., për shkak të veprave penale, Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së. Ndërsa të akuzuarit T., S., dhe Sh.M. i ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit në periudhën e verifikimit prej një viti nuk do të kryejnë vepër tjetër penale .

Janë obliguar të akuzuarit T., S., dhe Sh.M. të lirojnë pronën e uzurpuar sipas ngastrës me fletë posedim me numër 325 ZK-D. , Komuna e Gjakovës, konkretisht parcelat me numër 1020, 1036,3015, dhe 1037, këto të evidentuara si pronë shoqërore , në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Janë obliguar të akuzuarit T., S., dhe Sh.M. që në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) euro , kurse , në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) euro , gjithsej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro , të cilat duhet ti paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm .

Ndërsa i akuzuari G.J. të cilin gjykata e ka liruar nga akuza lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale .

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

- Mbrojtësi i të akuzuarit T.M., avokat M.S. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale , vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza dhe të anulohet aktgjykimi i ankimuar duke i'a kthyer çështjen gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.M., avokat B.K. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, zbatimit të gabuar të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike , duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza.

-I akuzuari S.M. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar , aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që i akuzuari të lirohet nga përgjegjësia penale.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.239/2018 të dt. 30.05.2018 ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe ajo e të akuzuarit S.M. meqë nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të potencuara në këto ankesa .

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat nuk janë të bazuara.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet nga ana e mbrojtësit të të akuzuarit T.M., av.M.S. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale duke pretenduar që arsyet e dhëna në arsyetimin e aktgjykimin të goditur janë në kundërshtim të tërësishëm me përmbajtjen e provave dhe të deponimeve në procesverbalin e shqyrtimit kryesor si dhe me vetë dispozitivin e aktgjykimin. Sipas mbrojtjes gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me administrimin e provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka bërë lëshime serioze si pasojë e një hetimi jo të gjithanshëm dhe të detajuar, është bërë një hetim i njëanshëm i cili në një mënyrë përmbush normën që duhet ta kryejë një prokurori sa për ta konsideruar si rast të përfunduar dhe asgjë më tepër e që në rastin konkret ka përfunduar me një aktgjykim të marrë të pabazuar në prova të besueshme nga ana e gjykatës. Mbrojtja parashtron pyetjen se si ka mundësi të dënohen për uzurpim këta persona kur Komuna e Gjakovës asnjëherë si pronare sipas gjendjes së tanishme kadastrale që paraqitet si pronare nuk ka qenë pjesëmarrëse si e dëmtuar në aktakuzën e prokurorisë apo nuk ka marrë pjesë në asnjë moment si e dëmtuar pranë gjykatës së shkallës së parë, por se është iniciuar procedurë penale me qëllim të eliminimit kinse të personave përgjegjës komunal që kanë pasur pozicione politike në atë kohë, e që të gjitha orvatjet kanë ardhur përmes këtij rasti “imagjinar”, prandaj me një vërtetim të gabuar të gjendjes faktike ka rezultuar edhe shkelja e ligjit penal në dëm të të akuzuarit, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin për një vepër penale që nuk ekziston përkatësisht nuk e ka kryer.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet nga ana e mbrojtësit të të akuzuarit Sh.M., av.B.K. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që i mbrojturit të tij nuk i janë dorëzuar shkresat e lëndës përveç aktakuzës deri para fillimit të shqyrtimit kryesor, dhe pasi që ka përfunduar shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë i akuzuari nuk ka pasur mundësi të paraqesë kërkesë dinjitoze për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave kur nuk e ka pasur asnjë provë apo shkresë të lëndës përveç aktakuzës, shkelje kjo e cila bie ndesh me nenin 244, dhe nenin 245 par.4 të KPP-së. Mbrojtja ankimon aktgjykimin për shkak të zbatimit të gabuar të Kodit Penal të Republikës së Kosovës pasi që sipas mbrojtjes, në veprimet e të mbrojturit të tij nuk qëndrojnë elementet kryesore të figurës së veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme neni 332 par.1 të Kodit Penal, për të cilën është shpallur fajtor. I njëjti aktgjykim ankimohet edhe për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike me pretendim se kemi një konstatim tërësisht të gabuar të gjendjes faktike, sepse gjykata ia falë besimin akteve juridike të njëanshme, të nxjerra nga njëra palë ku i kërkon palës tjetër lirimin e pronës, e sipas mbrojtjes është fakt i ditur se marrëdhëniet juridiko proënsorë janë marrëdhënie juridiko civile dhe të këto marrëdhënie ekziston parimi i barabarësisë së vullneteve të palëve dhe assesi nuk mundet njëra palë me akte juridike të njëanshme të vendosë nëse ka të drejtë të kërkojë kthimin e pronës apo jo. Si prova të cilat kanë rezultuar në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, mbrojtja përmend : Raportin e NHRERK , Aktvendimi nga Drejtoria për punë Juridike dhe Komacioni i datës 04.07.2008, Konkluzioni mbi lejimin e ekzekutimit, Kërkesa për ekzekutim të aktvendimit e parashtruar nga A.M., Kërkesa e drejtuar kryetarës së Komunës së Gjakovës, M.K. ,datë 14.04.2015,Konkluzioni i datës 03.03.2015, Certifikata pronësore e ngastrës kadastrale me nr.1020 në Zk Damjan, Procesverbali nr.14-355-368 i datës 03.07.2015, Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë e lëshuar me datë 15.10.2014, Skica e matjes që ka të bëjë me lëndën civile C.nr.673/14 e datës 03.11.2017, Ortofoto e vitit 2012, Aktvendimet e shtetit të Serbisë për bartjen e shënimeve kadastrale të Kosovës në qytetin e Krushevcit, Historiati i lëshuar nga drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe pronë në komunën e Gjakovës .

I akuzuari S.M. ka ankimuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, përkatësisht neni 384 i KPPK-së pasi aktgjykimi bazohet në provë të pranueshme, shkelje sipas të akuzuarit kemi edhe të nenit 370 nënpar 1.12 i KPP-së ku kërkohet nga gjykata në arsyetim të paraqet arsyen e çdo pike të aktgjykimit. Sipas të akuzuarit me aktgjykimin e ankimuar është bërë edhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike përkatësisht neni 385 i KPPK-së, pasi nga ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale e të akuzuarit S.M.. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo konkrete, duke shkelur nenin 384 të KPP-së. Në pretendimet ankimore të të akuzuarit pretendohet se vendimi mbi sanksionin penal e dëmton para së gjithash familjen, sepse është një veprë penale që nuk i takon kësaj familje, e sidomos ky kryefamiljar i cili ka edukuar fëmijë se tek e mira materiale arrihet me punë të ndershme.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe ankesën e të akuzuarit S.M. si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesa nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesa por edhe ato të cilat gjykata është e obliguar sipas detyrës zyrtare ti vlerësojë. I njëjti ka të paraqitura arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, është paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve si dhe arsyet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit apo mos ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarve në këtë çështje penale. Gjykata e shkallës së

parë në aktgjykim ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç duke i ndërlidhur me njëra tjetrën dhe duke e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat materiale dhe jo materiale dhe nga ato ka ardhur deri te një gjendje faktike e drejtë se të akuzuarit T., Sh. dhe S.M. në mënyrë të kundërligjshme kanë uzurpuar pronën e paluajtshme e cila është pronë publike shoqërore komunale e Gjakovës gjegjësisht parcelat 1020,1036,3016,3015,1037 të cilat janë të evidentuara si pronë shoqërore dhe se të akuzuarit S., inspektorët i kanë vendosur shiritin për të mos mundur të vazhdojë me ndërtimin e murit në pronë shoqërore dhe se i njëjti ka larguar shiritin duke vazhduar dhe përfunduar punën-ndërtimin e murit me betonim në ngastrën 1036 ndërsa i akuzuari T. me të njëjtën datë 11.11.2015 i prehen-hiqen shtyllat por i njëjti prapë i vendosë të njëjtat në ngastrën 1020 si dhe në ngastrën 1037 të ZK.Damjan. Ndërsa i akuzuari Sh.M. nuk e ka liruar pronën e uzurpuar, ngastrën 1020, pjesë të parcelës me numër 3016 dhe pjesën e parcelës 3015 të përshkruara me sipërfaqe saktësisht në aktgjykim të shkallës së parë. Kjo u vërtetua në bazë të dëshmitarit M. S.,meta në raportin policor të datës 15.03.2017, aktvendimit të Drejtorisë për punë Juridike dhe Komacion të datës 04.07.2008, Konkluzionin mbi lejimin e ekzekutimit të datës 25.02.2015, kërkesa për ekzekutimin e aktvendimit të datës 18.03.2014 nga parashtuesit A.M., Sh.M. dhe T.M. pasi janë njoftuar për plotfuqishmërinë e aktvendimit të datës 04.07.2008, kërkesa për ekzekutim e datës 17.12.2014 e paraqitur nga A.M., Sh. dhe T.M., njoftimi-kërkesa drejtuar M.K. e datës 14.04.2015 nga A.M. për të njëjtin uzurpim, konkluzioni i datës 03.03.2015 nga drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, certifikata pronësore me numër P-70713017-03015-OZK Damjan, plani për ngastrën 1020,1036,3015 dhe 3016, historiat i pronës i datës 27.02.2017, foto nga vendi i ngjarjes – pronës së uzurpuar, procesverbaleve me numër 14-385, kërkesa për inicim të procedurës kundërvajtëse e datës 06.11.2015, procesverbali i datës 03.07.2015; datë 02.07.2015, kopja e planit e datës 15.10.2014 e lëshuar nga republika e Serbisë me numër 350 për ngastrën 1020 si dhe provat e prezantuara nga mbrojtësi i të akuzuarit Sh.M. e të cilat gjykata e shkallës së parë i ka analizuar secilën veç e veç duke dhënë arsyet për faktet vendimtare dhe me të drejtë ka konstatuar gjendjen faktike se në veprimet e të të akuzuarve qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sepse të njëjtit kanë uzurpuar ngastrat kadastrale të cekura më lartë e të cilat janë evidentuar si pronë shoqërore ndërsa të njëjtit nuk i kanë përfillur vendimet e inspektoratit gjegjësisht i akuzuari S., duke hequr shiritin dhe vazhdimin e punës ndërtimore të murit në pronë shoqërore me betonim, i akuzuari T. duke vendosur përsëri shtyllat e prera dhe të hequra në ngastrën 1020 si dhe në ngastrën 1037 ndërsa i akuzuari Sh. nuk e ka liruar pronën e uzurpuar dhe atë të ngastrës kadastrale 1020, pjesë të parcelës 3016 dhe 3015, duke vepruar me dashje direkt edhe duke e ditur se fjala është për pronë në pronësi shoqërore dhe se po uzurpohet nga pronësia e personit tjetër në mënyrë të kundërligjshme, ndërsa provat e cekura më lartë demantojnë pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve se të njëjtit nuk kanë kryer veprën penale që iu është vënë në barrë.

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Sa i përket vendimit mbi dënim mbrojtësit e të të akuzuarve T. dhe Sh.M. nuk e atakojnë aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të vendimit mbi dënim ndërsa i akuzuari S.M. e ka theksuar si bazë ankimore por edhe ky sikur dy të akuzuarit e parë pretendojnë se vendimi mbi dënim nuk është i ligjshëm për faktin se ata nuk e ndiejnë vetën fajtorë për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe gjykuar si në aktgjykim të shkallës së parë. Pavarësisht kësaj kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare vlerësoi aktgjykimin e shkallës së parë edhe lidhur me vendimin mbi dënimin duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarve i ka shqiptuar dënimin me kusht secilit nga 6 (gjashtë) muaj e i cili nuk do të ekzekutohet në

periudhën e verifikimit prej 1(një) viti nëse ata nuk do të kryejnë vepër tjetër penale dhe se ky vendim duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese siç janë mosha ,janë mbajtës të familjes , janë penzionerë, gjendjen e dobët ekonomike, dhe në mungesë të rrethanave rënduese, me një dënim të tillë edhe kjo gjykatë vlerëson se do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.255 /2018, më 18.07.2018

Procesmbajtës,
Leonita Lajçi

Kryetari i kolegjit- gjyqtarja
1. Tonka Berishaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2.Dr.sc. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____